



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr. 1560, datë 20.04.2011

Për

“Për disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 20.04.2011, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

Për disa shtesa dhe ndryshime në Ofertën Referencë të Interkoneksionit të Eagle Mobile

BAZA LIGJORE:

1. Neni 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 të ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (**ligji nr. 9918**);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (**K.Pr.A**)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendshme të AKEP, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918 (**Rregullorja e Brendshme**);
4. Rregullore nr. 19 datë 14.06.2010 për “Aksesin dhe Interkoneksionin” miratuar me VKD nr. 1300, datë 14.06.2010 e ndryshuar (**Rregullorja**);

5. Rregullore nr. 13 datë 16.04.2010 per “ Portabilitetin e Numrit”, miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr.1219, Datë 07.04.2010.
6. Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” (Vendimi);

K Ë S H I L L I D R E J T U E S :

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, të përbërë nga:

1. Relacion shpjegues mbi projektvendimin (**Relacioni**);
2. Projektvendim i KD të AKEP për “Per disa shtesa dhe ndryshime në ofertën referencë të Eagle Mobile Sh.a” (**Projektvendimi**);
3. Komentet e operatorëve në vijim të takimit në AKEP më 1.4.2011 për implikimet e portabilitetit të numrit në interkoneksionin midis operatorëve:
 - a. Komentet e EM derguar me email me 6.04.2011;
 - b. Shkresa e Vodafone Albania me referencë LGD/0117/AC, datë 6.04.2011.
 - c. Shkresa e AMC me Nr.prot.3137/17, datë 6.04.2011;
 - d. Shkresa e Plus Communications me Nr. 208 Prot, datë 6.04.2011;
 - e. Shkresa e Albtelecom me nr. 1721 prot, datë 5.04.2011;
4. Vendimi nr. 1467, datë 23.12.2010 të Këshillit Drejtues të AKEP “Për miratimin e ofertës referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile sh.a” (Vendimi),
si dhe,
5. Diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N :

1. Procesi i implementimit të portabilitetit të numrave dhe rregullat e vendosura për rrugëzimin e thirrjeve drejt numrave të portuar krijon implikime në interkoneksionin midis rrjeteve dhe rrugëzimin e këtyre thirrjeve, të cilat duhet të adresohen në ofertat referencë të operatorëve me FNT dhe marrvëshjet e interkoneksionit midis operatorëve.
2. Grupi i punës për portabilitetin e numrave dhe drejtorja e rregullimit ekonomik kanë komunikuar me ekspertë ndërkombëtarë dhe zhvilluar një takim me operatorët kryesorë në treg më datë 1.04.2011, për implikimet që sjell portabiliteti i numrave në marrëdhëniet e interkoneksionit midis operatorëve dhe sidomos për thirrjet hyrëse ndërkombëtare dhe rastet kur tarifa e terminimit të thirrjeve në rrjetin marrës të numrit është e ndryshme nga tarifa e terminimit në rrjetin dhurues të numrit.
3. Impelementimi i portabilitetit të numrave celularë krijon implikime në disa drejtime kryesore për terminimin e thirrjeve:
 - a. Ofertat reference të interkoneksionit përmbajne përcaktime të cilat identifikojnë si abonent/pajtimtar të një rrjeti celular pajtimtarët që zotërojnë

numër celular që i përket serive numerike të alokuara nga AKEP operatorit përkatës celular. Me implementimin e portabilitetit të numrit ky identifikim nuk është më i vlefshëm dhe duhet reflektuar në ofertë referencë/marrveshje interkoneksioni, duke bërë përcaktim më të qartë termit abonent/pajtimtar i rrjetit.

- b. Bazuar në metodën “All call query” (ACQ) -kërkimi për çdo thirrje” të përcaktuar në rregulloren e portabilitetit, rrjeti origjinues, para vendosjes së çdo thirrje, përcakton rrjetin në të cilin numri i thirrur është i vendosur aktualisht duke kërkuar një pasqyrë lokale të bazës së të dhënave referencë të centralizuar. Gjithashtu sipas nenit 7 të rregullores së portabilitetit, detyrimi për të rrugëzuar thirrjen në rrjetin e duhur (vet ose me tranzitim) është I operatorit që origjinon thirrjen ose operatori i parë që merr një thirrje hyrëse ndërkombëtare. Nga këto përcaktime rezultojnë:
 - i. Një operator celular nuk ka detyrimin të pranojë nga një operator vendas thirrje drejt numrave që përkasin serive numerike të alokuara këtij operatori celullar dhe që janë portuar në rrjetet e tjera;
 - ii. Operatori celular ka detyrimin të pranojë thirrjet drejt numrave të operatorëve të tjerë dhe të portuar në rrjetin e tij;
 - iii. Operatori celular ka detyrimin të rrugëzojë drejt rrjeteve të tjera celulare thirrjet hyrëse ndërkombëtare me destinacion numrat e tij të portuar në rrjetet e tjera, thirrje të cilat i janë përcjellë nga një bartes ndërkombëtar (jo I autorizuar nga AKEP).
 - c. Detyrimi i pikës b/iii më sipër krijon kosto shtese për operatorin celular dhurues të numrit. Gjithashtu një implikim tjetër është rasti kur tarifa e terminimit në rrjetin dhurues dhe marrës janë të ndryshme.
4. Cështja më diskutuar ka qënë rasti i pikës 3.b.iii dhe 3.c më sipër. Operatorët celularë kanë shprehur qëndrime të ndryshme:
- a. Kostot shtesë të rrugëzimit duhet të kompensohen nga operatori marrës i numrit apo operatori terminues (operatori dhurues pagan operatorin marrës tarifën e terminimit në rrjetin e vet (dhurues) minus një tarifë për rrugëzimin e thirrjes.
 - b. Kostot shtesë (rrugëzim dhe terminim) duhet të paguhet nga operatorët origjinues (bartes ndërkombëtar) dhe të mos kete kompensime midis operatorëve dhurues dhe marrës (operatori marrës paguhet për tarifën e terminimit në rrjetin e vet).
5. AKEP gjykon se alternativa më e mirë është që kostot shtesë të paguhet nga operatorët origjinues (bartes ndërkombëtare):
- a. Operatorin dhurues i numrit i pagan operatorit marrës të numrit tarifën e terminimit si edhe për gjithë thirrjet e terminuar në këtë rrjet;
 - b. Kompensimi për kostot shtesë të rrugëzimit të thirrjeve nga operatori dhurues drejt operatorit marrës që kanë lidhje me rrugëzimin e thirrjes dhe nëse ka tarifë më të lartë terminimi në rrjetin marrës, është objekt i marrëdhënieve komerciale midis operatorit dhurues dhe bartesit ndërkombëtar.

6. Zgjidhja e dhënë në pikën 5 është në përputhje me rregulloren e portabilitetit të numrit dhe nxit përdorimin nga operatorët vendas të bazës lokale të të dhënave të numrave të portuar.
7. Cështjet dhe zgjidhjet e dhëna më sipër është e nevojshme të reflektohen me ndryshime ne ofertat referencë të interkoneksionit dhe MI midis operatorëve. Bazuar në pikën 32.2 të ofertës referencë të Eagle Mobile, ndryshimet e kryera në RIO-n e EM nëpërmjet këtij vendimi do të konsiderohen si pjesë të perfshira automatikisht në marrveshjen e interkoneksionit midis palëve, dhe me efekte nga data e përcaktuar nga AKEP për hyrjen në fuqi të tyre.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar në pikën 1 të nenit 114 dhe pikën 1 të nenit 115, të ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues të K.Pr.A, si dhe pikën 17 të nenit 21 të Rregullores së Brendshme,

V E N D O S :

1. Në ofertën referencë të interkoneksionit të Eagle Mobile Sh.a. të miratuar me VKD nr.1467, datë 23.12.2010 (i ndryshuar), të kryhen ndryshimet e mëposhtëme:

a. Në Seksionin I. Psembledhje të shtohet pika ‘n’ si më poshtë:

Kjo Oferte Reference Interkoneksioni mbulon terminimin per thirrjet drejt pajtimtareve/abonentet e rrjetit Eagle Mobile, të cilat janë ata abonentë që:

- *Kane numer celular qe i perket serive numerike (067xxxxxx) të alokuar nga AKEP Eagle Mobile, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjetër, ose*
- *Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Eagle Mobile, por qe eshte portuar ne rrjetin e Eagle Mobile.*

Eagle Mobile ka detyrimin të pranojë per terminim vetëm thirrje telefonike te destinuara per abonentet/pajtimtaret e Eagle Mobile, të cituar më sipër, dhe është përgjegjësia e operatorit përfitues të rrugëzojë thirrjet drejt rrjetit të duhur për numrat e portuar, duke bere analizen e thirrjeve ne perputhje me rregullat e vendosura nga AKEP per portabilitetin e numrave dhe rruezimin e thirrjeve drejt tyre.

b. Në Aneks 1 “Perkufizime dhe Shkurtime”, në pikën 1.1 të shtohen përkufizimet e mëposhtëme:

“Abonent/pajtimtar i rrjetit Eagle Mobile”: abonentet/pajtimtaret qe:

1. *Kane numer celular qe i perket serive numerike 067 xx xxxxx të alokuar nga AKEP Eagle Mobile, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjetër, ose*

2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike 067 xx xxxxx te alokuar nga AKEP Eagle Mobile, por qe eshte portuar ne rrjetin e Eagle Mobile.

“Abonent/pajtimtar i rrjetit te Operatorit Perfitues”: abonentet/pajtimtaret e rrjetit

Operatorit Perfitues qe:

1. Kane numer qe i perket serive numerike të alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, numer i cili nuk eshte portuar ne rrjetin e nje operatori tjeter, ose
2. Kane numer qe nuk i perket serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, por qe eshte portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues.

- c. Në Aneks 1 “Perkufizime dhe Shkurtime”, në pikën 1.1, përkufizimi i termit “Sherbimi i Terminimit ne Eagle Mobile” të ndryshohet si më poshtë:**

Sherbimi nepermjet te cilit Eagle Mobile, ne emer te Operatorit Perfitues percjell Thirrjet nga Pika e Interkoneksionit per ne nje Pike fundore te Rrjetit te tij ne Republikën e Shqiperise, te identifikuar nepermjet numrave te abonenteve/pajtimtareve te Eagle Mobile.

- d. Në Aneks II “Shërbimet dhe Tarifate e Interkonksionit”, në pikat 2.1 Shërbimi 201, pika 2.3.3.1, pika 2.4.2 numri 201, Kolona ‘Shërbimi’, teksti i mëposhtëm:**

Sherbimi i terminimit te thirrjeve kombetare te dorezuara nga Eagle Mobile drejt abonenteve te rrjetit te Operatori Perfitues perfshire:

- a. *thirrje te origjinuara nga abonentet e Eagle Mobile;*
- b. *thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republikën e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Eagle Mobile*

të zëvendësohet me:

Sherbimi i terminimit te thirrjeve te dorezuara nga Eagle Mobile drejt abonenteve te rrjetit te Operatori Perfitues perfshire:

- a. *thirrje te origjinuara nga abonentet e Eagle Mobile;*
- b. *thirrje te gjeneruara nga abonentet e rrjeteve te tjera publike telefonike ne Republikën e Shqiperise dhe qe rregullisht jane te tranzituara nga rrjeti i Eagle Mobile*
- c. *thirrje te origjinuara nga rrjete nderkombetare, te percjella me interkoneksion direkt te Eagle Mobile me bartes nderkombetare (jo i autorizuar nga AKEP), drejt numrave te Eagle Mobile te portuar ne rrjetin e operatorit perfitues (operator rrjeti celular ne RSH)*

- e. Në Aneks II “Shërbimet dhe Tarifate e Interkonksionit”, në pikën 2.4.2 numri 201, Kolonat ‘Tarifa për Kohëzgjatje’, ‘Tarifa për Thirrje’ të shtohet teksti i mëposhtëm:**

Niveli i tarifës se terminimit të Operatorit përfitues (i njëjtë për të tre llojet e thirrjeve të terminura)

f. Në Aneks V “Numeracioni dhe CLI”, pikat 5.1.11 dhe 5.1.12 të ndryshone si më poshtë vijon:

5.1.11 Dergimi i thirrjeve nga Operatori Perfitues drejt rrjetit të Eagle Mobile do të kryhet sipas serive numerike vijuese të Eagle Mobile:

<i>Gjatesia (Nr. i dixhiteve)</i>	<i>Serite Numerike</i>	<i>Lloji i numrit</i>
	<p>I. 0 67 ABCDEFG (A = 1 deri ne 9) (BCDEFG = 0 deri ne 9) <i>(pervec numrave te cilat jane portuar ne rrjetet e operatoreve te tjere)</i></p> <p>II. <i>Numra te serive numerive te alokuar operatoreve te tjere celulare ne RSH, 06Y xx xxxxx, por te portuar ne rrjetin Eagle Mobile</i></p>	<i>Abonent/perdorues</i>
		<i>Sekretaria telefonike</i>
		<i>Kujdesi per Klientin</i>
		<i>Rimbushja e kreditit (Rimbushja me Parapagim)</i>

Operatori perfitues duhet te kryeje analizen e numrave dhe te dergoje thirrje drejt Eagle Mobile duke përfshirë kodin e rrugëzimit 9903 të alokuar nga AKEP për Eagle Mobile, ne perputhje me rregulloren e portabilitetit te numrit

5.1.12. Dergimi i thirrjeve nga Eagle Mobile tek rrjeti i Operatorit Perfitues do të kryhet sipas serive numerike të Operatorit Perfitues si me poshte:

<i>Gjatesia (Nr. i dixhiteve)</i>	<i>Serite Numerike</i>	<i>Lloji i numrit</i>
<i>x</i>	<p>I. <i>Seritë numerike të operatorit përfitues të alokuar nga AKEP, përvec numrave të portuar në rrjete të tjera</i></p> <p>II. <i>Numra qe nuk i perkasin serive numerike te alokuar nga AKEP Operatorit Perfitues, por qe janë portuar ne rrjetin e Operatorit Perfitues</i></p>	

Eagle Mobile duhet te kryeje analizen e numrave dhe te dergoje thirrje drejt operatorit përfitues duke përfshirë kodin e rrugëzimit _____ të alokuar nga AKEP për operatorin përfitues, ne perputhje me rregulloren e portabilitetit te numrit

2. Ndryshimet e ofertës referncë të interkoneksionit të EM të përcaktuar në pikën 1 më sipër, hyjnë në fuqi në datën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.
3. Ky Vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I
Piro XHIXHO

ANËTARET:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**